



Komuna e Lipjanit


**PLANI I PUNËS I EKPIT
PËR TË DREJTAT E
FËMIJËVE
(2024 – 2026)**

LISTA E SHKURTESAVE

AK	Asambleja Komunale
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DKA	Drejtoria e Arsimit
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DSHPS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
EDF	Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve
KK	Kuvendi Komunal i Lipjanit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
OJQ	Organizata Joqeveritare
QPS	Qendra për Punë Sociale
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e fëmijëve
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm / Sustainable Development Goals

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1.0 HYRJE	6
2.0 METODOLOGJIA.....	7
3.0 FONDI.....	8
3.1 Demografia e Komunës së Lipjanit	9
3.2 Shëndetësia.....	10
3.3 Mirëqenia sociale.....	11
3.4 Arsimi.....	12
4.0 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE.....	13
4.1 Përmirësimi i mbrojtjes, sigurisë, rinteprimit, risocializimit dhe mirëqenies sociale	14
4.2 Përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë.....	15
4.3 Zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor dhe gjithpërfshirës.....	Error! Bookmark not defined. 6
4.4 Ofrimi i programeve të Edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit.....	Error! Bookmark not defined. 7
4.5. Fuqizimi i mekanizmit komunal për të drejtat e fëmijës	Error! Bookmark not defined. 7
5.0 Zbatimi dhe monitorimi i planit të punës.....	Error! Bookmark not defined. 8
6.0 Ndikimi buxhetor për zbatimin e planit të punës.....	Error! Bookmark not defined. 8
7.0 Plani i veprimit për EDF për vitin 2024-2026.....	19



Grupi punes për hartimin e Planit të Punë për EDF:

1. Imri Ahemeti, Kryetar i Komunës, kryesues i Ekipit;
2. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale zëvendës kryesues i Ekipit;
3. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar;
4. Albert Mustafa, Shef i Sektorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar;
5. Anila Reçica-Llugiqi, Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare;
6. Latif Ramadani, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, anëtar;
7. Daut Azemi, Kryesues i komitetit për politikë dhe financa, anëtar;
8. Skender Bikliqi, Kryesues i komitetit për komunitete, anëtar;
9. Fjolla Ibrahim, Zyrtare për Mbrojtjen e fëmijëve-QPS, anëtare;
10. Florentina Murtezi, policia- Lipjan, anëtare;
11. Lorik Berbatovci, Qendra për Punë Sociale, anëtar;
12. Bekim Krasniqi, përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar;

Puna e Grupit Punues në hartim të Planit të Punë për EDF është mbështetur edhe nga zyra e UNICEF-it në Kosovë, ku është angazhuar edhe konsulenti z. Donat Rexha.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komuna e Lipjanit promovon të drejtat dhe mirëqenien e çdo fëmije. Investimi në fëmijët tanë ka një rëndësi vendimtare për të ardhmen e Kosovës. Fëmijët e sotëm 10 vjeçar janë fuqia punëtore e vitit 2030, që do të thotë se kujdesi për të gjithë fëmijët sot është investimi vendimtar për të ardhmen e Kosovës dhe për të siguruar një mjedis konkurrues për shtetin e Kosovës.

Prandaj, Komuna e Lipjanit përmes themelimit dhe funksionimit të Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve (EDF), Vendimi INr.020/05-58800¹ i datës 31.10.2022, që rrjedh si obligim nga Udhëzimi administrativ (QRK) nr. 06/2022², do të ofrojë mundësi për të analizuar politikat ekzistuese, pasqyrimin socio-ekonomik dhe financiar për çështjet e fëmijëve, identifikojnë nxitësit kryesorë të pabarazive dhe sfidat kryesore për të përmbushur të drejtat e fëmijëve dhe ofron rekomandime për zhvillimin e politikave adekuate dhe prioritizimin e investimeve për fëmijët si aset kyç për zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit. Më tutje, do të kontribuojë në informimin dhe rritjen e llogaridhënies dhe reagimit të institucioneve lokale ndaj të drejtave të fëmijëve dhe grave.

Plani i punës për të drejtat e fëmijëve është hartuar nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) dhe me mbështetjen e Unicef-it, me pjesëmarrjen e gjerë të anëtarëve të EDF dhe ekspertëve të fushave të ndryshme në bashkëpunim dhe partneritet me zyrën e UNICEF në Kosovë. Plani është hartuar duke u konsultuar dhe pasur në qendër zërin, nevojat dhe prioritetet e fëmijëve të komunës së Lipjanit dhe reflekton plotësisht nevojat e fëmijëve të Komunës së Lipjanit të identifikuar gjatë punësive të EDF si dhe komunikimit të rregullt mes drejtorive përgjegjëse dhe zyrës së Unicef-it si këshilltarë të jashtëm. Si i tillë, ky plan është real, përmbajtësor dhe bazohet në gjendjen aktuale dhe objektivat zhvillimore të komunës.

Ekipi i hartimit të Planit të Punës ka vendosur që të përcaktohen dhe harmonizohen objektiva strategjike bazuar në nevojat, përgjegjësitë dhe kompetencat në nivel lokal, si:

Objektiva strategjike #1: Përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë;

Objektiva strategjike #2: Përmirësimi i mbrojtjes, sigurisë, ri-integritimit, risocializimit dhe mirëqenies sociale;

Objektiva strategjike #3: Zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor dhe gjithpërfshirës;

Objektiva strategjike #4: Ofrimi i programeve të Edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit;

Objektiva strategjike #5: Fuqizimi i mekanizmit komunal për të Drejtat e Fëmijëve;

Përmbushja e këtyre objektivave do të kontribuojnë në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë (SDGs). Objektivat

¹ Vendim me INr.020/05-58800, për Themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve në Komunën e Lipjanit

²Udhëzim administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijëve, është aprovuar në mbledhjen e 92 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 02/92, datë 10.08.2022

strategjike janë në përputhje dhe kontribuojnë në qëllimin kryesor të Agjendës 2030³ që bënë thirrje për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format dhe eliminimin e pabarazive (SDGs 1, 5 dhe 10), rritjen e mundësive të të gjithë fëmijëve që të kenë sukses në të arriturat arsimore (SDGs 4), shërbime kualitative shëndetësore dhe sociale (SDGs 2 dhe 3), parandalimin e dukurive negative dhe dëgjimi i zërit të tyre (SDGs).

1.0 Hyrje

Komuna e Lipjanit përmes Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve (EDF) do të ofrojë mundësi për të analizuar politikat ekzistuese, pasqyrimin socio-ekonomik dhe financiar për çështjet e fëmijëve, identifikojnë nxitësit kryesor të pabarazive dhe sfidat kryesore për të përmbushur të drejtat e fëmijëve dhe ofron rekomandime për zhvillimin e politikave adekuate dhe priorizimin e investimeve për fëmijët si aset kyç për zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit. Ajo do të kontribuojë më tej në informimin, rritjen e llogaridhënies dhe reagimit të institucioneve lokale ndaj të drejtave të fëmijëve dhe grave.

Realizimi i të drejtave të njeriut, fillon me investimin në fëmijë, rezultatet e të cilit janë të ndërlidhura në nivel të lartë të produktivitetit për ekonomin, gjendjen sociale dhe zhvillimin e vendit. E ardhmja e një shteti varet shumë nga fakti nëse qytetari i saj është i shëndetshëm dhe i arsimuar. Andaj, pavarësisht vështirësive me të cilat vazhdon të përballlet shteti, investimi në fëmijë është gjëja e duhur dhe e domosdoshme për t'u bërë drejt prosperitetit të mirëqenies së fëmijëve dhe realizimit të të drejtave të tyre⁴.

Nëpërmjet fuqizimit të bashkëpunimi të përhershëm me qytetarët, prindërit, arsimtarët, profesionistët shëndetësor, shërbimet sociale, shërbimet kulturore e sportive si dhe organizatat relevante, ne do të rrisim cilësinë e shërbimeve duke garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve tanë. Ky plan komunal do të jetë një udhërrëfyes i veprimeve të nevojshme për të mbështetur fëmijët tanë, për t'u siguruar një të ardhme të ndritshme dhe të lumtur në qytetin tonë.

Prioritetet e planit të punës janë:

- Arsimi cilësor dhe gjithpërfshirës: Sigurimi i një arsimi cilësor dhe të qasshëm për të gjithë fëmijët, përfshirë ndihmë për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe për ata që janë në rrezik të braktisjes nga shkolla.
- Mbrojtja shëndetësore dhe sociale: Përmirësimi i qasjes në kujdes shëndetësor për fëmijët, përfshirë vizitat në shtëpi, vaksinimin, kujdesin për sëmundje të ndryshme dhe shëndetin mendor. Gjithashtu, garantimi i mbështetjes sociale për fëmijët në nevojë dhe gjithpërfshirjen në sistemin shëndetësor dhe mbrojtje sociale.

³Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 25 shtator 2015, [chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N15/291/89/PDF/N1529189.pdf?OpenElement](https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N15/291/89/PDF/N1529189.pdf?OpenElement)

⁴Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve për vitin 2019-2023 të Republikës së Kosovës;

- Mbrojtja nga Dhuna dhe Keqtrajtimi: Parandalimi dhe luftimi i çdo forme dhune dhe keqtrajtimi ndaj fëmijëve, duke përfshirë masa për ndalimin e dhunës në familje, shkolla dhe komunitet.
- Zhvillimi Kulturor dhe Artistik: Sigurimi i mundësive për fëmijët që të marrin pjesë në aktivitete kulturore, artistike dhe rekreative që ndihmojnë në zhvillimin e tyre të plotë.
- Përfshirja dhe Vendimmarrja e Fëmijëve: Inkurajimi i përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje që i përket atyre, duke i dëgjuar dhe marrë parasysh mendimet dhe idetë e tyre.
- Ndërgjegjësim dhe Edukim: Sensibilizimi i komunitetit për rëndësinë e të drejtave të fëmijëve dhe përgatitja e fëmijëve për të ndërgjegjësuar veten për të drejtat e tyre.
- Krijimi i një Mjedisi të Sigurt dhe Mbështetës: Përmirësimi i mjedisit të përgjithshëm për fëmijët në komunë, duke garantuar sigurinë dhe ndihmën e nevojshme për zhvillimin e tyre.
- Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Bashkëpunimi: Përmirësimi i kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me fëmijët dhe bashkëpunimi me organizatat lokale dhe ndërkombëtare për të forcuar efektivitetin e veprimeve për të drejtat e fëmijëve.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit: Krijimi i një sistemi të përhershëm për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave dhe veprimtarive të planit të punës për të drejtat e fëmijëve.

Pra, qëllimi EDF është të prioritzoj nxitjen e llogaridhënies, planifikimin, koordinimin, dhe monitorimin në nivel komunal si dhe krijimin e një komune gjithpërfshirëse.

2.0 Metodologjia

Plani për EDF është hartuar duke u bazuar në një metodologji të kombinuar në mënyrë që të jetë gjithpërfshirës, të adresojë prioritetet kyçe bazuar në evidencë dhe të siguroj që intervenimet e përcaktuara do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike. Format i planit të EDF është i bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit⁵, ku përgjatë procesit të hartimit të planit janë organizuar punëtori dhe takime individuale me akterët kyç, duke përfshirë përfaqësues nga sektorët relevante në kuadër të DSHPS, DKA, QKMF, DKRS, DBF, QPS, MAPL, dhe institucione tjera të angazhuara për të drejtat e fëmijëve, përfshirë OJQ-të lokale etj. Gjithashtu, janë organizuar tri takime në formë të punëtorisë me Ekipin për Mbrojtjen e Fëmijëve, mbështetur nga UNICEF nga ku janë nxjerr konkluzionet e këtij plani. Pas analizimit të gjendjes aktuale, janë përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet dhe veprimet konkrete, të cilat janë buxhetuar.

⁵Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18813>;

Procesi i hartimit të strategjisë ishte i ndarë në tri faza: 1) faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, si dhe realizimin e një seri të takimeve konsultative, në të cilat kanë qenë të përfshirë fëmijët dhe aktorët relevant që punojnë në nivel lokal; 2) përgjatë fazës së dytë Ekipi përgjegjës për hartimin e planit të punës ka analizuar dokumentet e ndryshme strategjike në fuqi, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve për vitin 2019-2023⁶, Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (KDF)⁷, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)⁸, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS)⁹, Korniza ligjore për të Drejtat e fëmijëve në Kosovë¹⁰, Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve dhe grave¹¹, Analiza e situatës mbi Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme¹².

Si i tillë, ky program është real, përmbajtësor dhe bazohet në gjendjen aktuale dhe objektivat zhvillimore të komunës. Plani i Punës i EDF kalon në fazat: Dëgjimi publik dhe votimi nga AK.

3.0 Sfondi

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve është një dokument themelor dhe korniza ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Ajo ka ndikuar thelbësisht në ndërmarrjen e hetimeve, politikave dhe veprimeve në nivel ndërkombëtar dhe në nivele vendore për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve në mënyrë adekuate dhe të përmbushë nevojat e tyre për zhvillim dhe mirëqenie.

Kjo konventë është një shembull i një dokumenti ndërkombëtar që ka bashkuar komunitetin ndërkombëtar për të rritur ndërgjegjësimin dhe të ndihmuar në përmirësimin e jetës së fëmijëve në të gjithë botën. Përmes angazhimit të shteteve anëtare, organizatave joqeveritare dhe institucioneve të ndryshme, Konventa ka qenë një shkallë e rëndësishme përpara në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të drejtave të fëmijëve.

Pra, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve paraqet themelet e secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijëve. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale. Në nivelin nacional, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Në Kosovë, në vitin 2019 është miratuar Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ky ligj është miratuar dhe i ka hapur rrugën operacionalizimit të tij përmes akteve nënligjore dhe

⁶Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve për vitin 2019-2023 të Republikës së Kosovës;

⁷Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>;

⁸ <https://www.un.org/sustainabledevelopment/>;

⁹ <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-grupimeve-te-treguesve-te-shumefishte>;

¹⁰ LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE;

¹¹ https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/CRSA_Kosovo_2013%20December_2.pdf

¹² https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Analiza%20e%20situates_ALB%20me%20cover%20page.pdf;

krijimit e funksionimit të mekanizmave mbrojtës për fëmijët. Kështu Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve¹³ ndër të tjera përcakton që Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve krijohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës në nivel të vendimmarrjes politike. Në nenin 20 jepen edhe konturat e fushëveprimit të këtij ekipi. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë udhëzimin administrativ 06/2022¹⁴ për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijëve, që përcakton mënyrën e themelimit dhe aspektet e funksionimit të këtij ekipi.

Në nivelin lokal, Komuna e Lipjanit në vitin 2021 ka aprovuar Rregulloren 15Nr.553-35835, të datë 30.06.2021 Për Kujdesin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Qëllimi i rregullores ishte që përmes sistemit qeverisës komunal t'i kontribuohet krijimit të një komune mike për fëmijët.

Ndërsa, me datën 11.10.2022 duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe Udhëzimin Administrativ (Qrk) Nr. 06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr vendim me Vendimin INr.020/05-58800, i datës 31.10.2022)¹⁵, për themelimin e Ekipës për të Drejtat e Fëmijëve.

3.1 Demografia e Komunës së Lipjanit

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Lipjanit është 57,605 banorë.

Pjesa më e madhe e popullsisë janë shqiptarë 94.8 %, ndërsa 0.88 % janë serb, kroatë: 0.41 %, romë: 3.67% dhe 0.03 % të tjerë. Moshja e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40% janë të moshës 0 -14 vjeç, 45% janë të moshës 15 -65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç. Mesatarja e madhësisë së familjeve është pesë anëtarë.¹⁶

3.2 Shëndetësia

Sa i përket të dhënave shëndetësore, në Komunën e Lipjanit ka gjithsej 12 qendra të kujdesit Parësor Shëndetësor, të cilat mbulojnë territorin e komunës si në vijim: në qytetin e Lipjanit është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), kurse zonat rurale janë të mbuluara me katër (4) Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) të cilat gjenden në fshatrat: Shalë, Magurë, Gadime dhe Janjevë dhe me shtatë (7) Ambulanca të mjekësisë Familjare (AMF), të cilat janë të vendosura në fshatrat: Sllovi, Smallushë, Banullë, Babush, Kraishtë dhe Dobrajë. Largësia mesatare e arritjes në qendër shëndetësore nga vendbanimet në komunën e Lipjanit është afërsisht 5- 6 km, largësia maksimale.

Aktualisht (v.2023) numri i përgjithshëm i profesionistëve të kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Lipjanit është 188, nga të cilët janë 57 mjekë (21 Mjekë Familjar, 24 Mjekë të Përgjithshëm, 1 Gjinekolog-Obstetër, 1 Radiolog, 1 Pediatër, 9 Stomatolog), 131 infermier/e


¹³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

¹⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>

¹⁵ Vendim me INr.020/05-58800, për Themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve në Komunën e Lipjanit

¹⁶ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/qyteti/numri-i-banoreve/>

Grafiku 2. Profesionistët shëndetësor



Burimi: QKMF Lipjan.

Në QKMF-Lipjan janë aktualisht 29 mjekë, dhe 93 infermier/e, teknik të laboratorit, teknik të farmacisë, teknik dentar dhe mami. Në QMF dhe AMF janë 15 mjekë dhe 45 infermier/e, teknik të laboratorit dhe teknik dentarë.

Në raportin mjekë familjar/mjekë i përgjithshëm në KPSH-Lipjan është: një(1) Mjek Familjar/Mjek i Përgjithshëm për çdo 1,280 banorë.

Kurse sa i përket mbulueshmërisë së territorit të Komunës së Lipjanit me institucione shëndetësore, ekziston një qendër e kujdesit shëndetësor për 4,800 banorë, kurse për moshat nën 20 vjeç 1 qendër e kujdesit shëndetësor për 1908 fëmijë, (bazuar në statistikat e vitit 2011 të ASK).

3.2.1 Numri i lindjeve

Në vitin 2020-2022 sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të lindur gjallë, sipas vendit të përhershëm të nënës në komunë, gjinisë, statusi martesor të prindërve dhe vendit ku ka lindur fëmija, gjithsej lindje të gjalla në Komunën e Lipjanit kanë qenë 872 fëmijë. Në aspektin gjinor: Meshkuj 434 dhe Femra 438. Në aspektin e statusit martesor me kurorë: 645, kurse statusi martesor pa kurorë-227.

Numri i përgjithshëm i lindjeve në maternitetin e QKMF-Lipjan ishte 4 lindje. Nga këto lindje në aspektin gjinor ishin tri (3) të posalindura femra dhe një (1) i posalindur mashkull. Lindje të gjalla (75% femra, 25% meshkuj). Këto lindje kanë ndodhur në institucionin mjekësor në maternitetin e QKMF-Lipjan dhe janë kryer me ndihmë mjekësore. Të gjitha (100%) e këtyre lindjeve ishin nga nënat e moshës 20-34 vjeç, (v.l. 1988-Ashkalike, v.l. 1991 Shqipëtare, v.l. 1993-Shqipëtare, v.l 1996-Shqipëtare) me një moshë mesatare të nënave prej 31 vjeçe. Për më tepër, popullata shqipëtare është mbi 95% shqipëtare nga popullata e përgjithshme, në

përkatësi etnike: 3 lindje ishin nga prindër shqipëtarë, kurse një lindje i përkiste prindërve Ashkali. Kjo përqindje e lindjeve në maternitetin e QKMF-Lipjan nuk pasqyron realitetin e raportit në përqindje të lindjeve në baza etnike.

3.3 Mirëqenia sociale

Bazuar në të dhënat e ASK-së për mirëqenien sociale në vitin 2022 janë 5,804 anëtarë të familjeve të Komunës së Lipjanit në skemën e ndihmës sociale. Nëse e krahasojmë me të dhënat e vlerësimit të popullsisë në fund të vitit 2022 del se 10% e banorëve të Lipjanit janë në skemën e ndihmës sociale.


Në vitin 2022 numri i fëmijëve përfitues nga ofrimi i shërbimeve sociale në Komunën e Lipjanit është 199 fëmijë dhe numri i fëmijëve të ri-integruar dhe ri-socializuar është 19 fëmijë, si dhe numri i familjeve strehuese është 2.

Sa i përket buxhetit në vitin 2023, ndarja buxhetore për shërbime sociale ka qenë 185,000.00€, kurse planifikimi për vitin 2024 ka shënuar rritje 230,000.00€.

3.4 Arsimi

Komuna e Lipjanit ka gjithsej 27 shkolla, nga të cilat 24 janë fillore dhe të ulta dhe 3 janë institucione të mesme të larta. Numri i përgjithshëm i mësuesve është 845, nga të cilët 682 japin mësim në arsimin parafillor, fillor dhe shkollë të mesme të ulët, ndërsa 163 japin mësim në shkollat e mesme.

Grafikun 5. Ndarja e paraleleve dhe mësimeve



Burimi: DKA

3.4.1 Ofrimi i edukimit gjithpërfshirës

3.4.1.1 Edukimi i fëmijërisë së hershme

Në Lipjan, ekziston arsimi parafillor (parashkollor) me gjithsej 1 kopsht publik dhe 3 njësi të ndara në Gadime, Sllovi dhe një në Shalë të hapur në nëntor 2023 si dhe 4 kopshte private. Në kopshtet publike në Lipjan janë regjistruar 185 fëmijë, prej tyre 98 meshkuj dhe 87 femra, në p.n.f në Gadime 51 nxënës, prej tyre 25 meshkuj dhe 26 femra, ndërsa në Sllovi 29 nxënës, prej tyre 15 meshkuj dhe 14 femra, ndërsa në Shalë janë gjithsejt 39 fëmijë prej tyre 21 meshkuj dhe 18 femra.


Përveç kësaj, ekzistojnë edhe institucionet parashkollore me bazë në komunitet për zhvillimin në fëmijërisë të hershme (ZhFH) në fshatin Magurë 34 fëmijë, prej tyre 16 meshkuj dhe 18 femra dhe në Shalë deri në hapjen e kopshti publik në teor kanë qenë 22 fëmijë, prej tyre 12 meshkuj e 10 femra. Këto institucione janë bashkefinancuar nga Zyra e UNICEF-it.

Komuna e Lipjanit, tani është në proces të ndërtimit të 2 kopshteve të reja publike në vendet rurale, në fshatin Magurë dhe Rufe i Ri.

3.4.1.2 Edukimi fillor dhe i mesëm i ulët

Në edukimin fillor dhe të mesëm të ulët, arsimi në Lipjan ka 24 shkolla me 9031 nxënës gjithsej. Nga të cilët, 4320 janë vajza dhe 4711 janë djem. Numri mesatar i nxënësve për shkollë është 376.29. Numri mesatar i nxënësve për një mësues është 13.24.

Grafiku 7. Edukimi fillor dhe i mesëm i ulët




Burimi: DKA

3.4.1.3 Edukimi i mesëm i lartë

Në arsimin e mesëm të lartë, ekzistojnë 3 shkolla në Lipjan, me 2246 nxënës të regjistruar, nga të cilat 1092 janë vajza dhe 1154 janë djem. Në arsimin e mesëm të lartë numri mesatar i fëmijëve për shkollë është 748.66 dhe numri mesatar i nxënësve për mësues është 13.77

nxënës.


Grafiku 8. Edukimi i mesëm i lartë



Burimi: DKA

3.4.2 Shpenzimet në arsim

Grafiku 9: Shpenzimet në arsim sipas niveleve



Burimi: DKA

4.0 Objektivat strategjike dhe specifike

Objektivat strategjike dhe specifike të paraqitura në këtë dokument janë identifikuar duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në analizën e gjendjes aktuale të komuniteteve në këtë dokument strategjik, informatave nga terreni dhe rekomandimeve të ofruara nga grupi punues. Përveç objektivave të identifikuara, janë zhvilluar edhe aktivitete konkrete të paraqitura në Planin e Veprimit.

Vizioni i Komunës së Lipjanit është: *Lipjani, komunë miqësore për të gjithë fëmijët pa dallim, ku promovohen dhe realizohen parimet themelore të të drejtave të tyre për arritjen e potencialit*

të plotë, në përputhje me standardet afirmative, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për ta arritur këtë vizion, Komuna e Lipjanit merr për obligim të fuqizoj sistemin e qeverisjes komunale që mundëson përmirësimin e mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve të komunës, duke u angazhuar për krijimin e mirëqenies së fëmijëve me pjesëmarrjen e vet fëmijëve, si dhe duke bashkëpunuar me të gjitha palët në mënyrë që fëmijët ta krijojnë ndjenjën e përkatësisë në komunitet. Ky është misioni i këtij plani.

Me zbatimin e këtij plani, synohet që të përmirësohet mirëqenia e fëmijëve në sferën e arsimit, punësimin, mirëqenies sociale, strehimit familjar, shëndetësisë, si dhe kulturës e sportin për të gjithë fëmijët që jetojnë në Komunën e Lipjanit.

Ky plani i punës për EDF është i bazuar në 5 objektiva kryesore:

4.1 Objektiva strategjike #1: Përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë;

Në kuadër të Planit të Punës për të EDF, një prej qëllimeve kryesore është përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë në komunën tonë. Nëpërmjet hetimeve të thella të situatës dhe konsultimeve me ekspertë, kemi identifikuar disa hapa të rëndësishëm për të arritur këtë qëllim e të cilët janë:

Objektiva specifike #1.1: *Zbatimi i programit të vizitave në shtëpi* - ky program kërkon një qasje të rregullt, përgjegjëse dhe të përshtatshme për të siguruar kujdesin dhe zhvillimin e mirë të fëmijëve në moshën e hershme. Komuna e Lipjanit përmes këtij programi synon të ndikojë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve përmes përkrahjes dhe edukimit të prindërve, si dhe monitorimit të rregullt të gjendjes së fëmijëve. Në kuadër të kësaj objektive janë paraparë katër objektiva specifike:

Objektiva specifike #1.2: *Zbatimi i Programit të Imunizimit të Rregullt për Fëmijët* - Imunizimi është një nga mënyrat më të efektshme për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive dhe për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve. Zbatimi i një Programi të Imunizimit të Rregullt është një përpjekje thelbësore për të siguruar që fëmijët të jenë të mbrojtur nga sëmundjet potencialisht të rrezikshme. Zbatimi i një Programi të Imunizimit të Rregullt është ndër hapat kyç për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve dhe për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme. Ky program ka ndikim të gjerë në shëndetin publik dhe kontribuon në krijimin e një shoqërie më të shëndetshme dhe të sigurt për të gjithë.

Objektiva specifike #1.3: *Zbatimi i Programit të Kontrolleve Sistematike Shëndetësore në shkollë* – Programi i Kontrolleve Sistematike Shëndetësore në shkollë është një iniciativë e rëndësishme për të siguruar monitorimin dhe përmirësimin e shëndetit të fëmijëve gjatë kohës që ata janë në mjedisin shkollor. Kjo është një mënyrë e rëndësishme për të identifikuar dhe trajtuar herët çdo problem shëndetësor që mund të prekë fëmijët, si dhe për të promovuar ndërëgjegjësimin e tyre për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Ky program ndikon në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve, duke krijuar një shoqëri më të shëndetshme dhe më të përgjegjshme.

Objektiva specifike #1.4: *Programi i promovimit dhe edukimit shëndetësor në shkollat fillore dhe të mesme* – Programi i promovimit të edukimit shëndetësor dhe shëndetit mendor në shkolla fillore dhe të mesme është një përpjekje e rëndësishme për të ndërgjegjësuar dhe edukuar fëmijët dhe të rinjtë mbi rëndësinë e kujdesit për shëndetin e tyre, të trupit dhe mendjes. Ky program synon të promovojë një mjedis shëndetësor dhe mësimor duke përfshirë temat e edukimit shëndetësor dhe shëndetit mendor nëpërmjet sesioneve të informimit të organizuara në shkollat e Komunës së Lipjanit. Disa nga përfitimet e këtij programi janë: ndërgjegjësimi për praktikën e shëndetshme, përmirësimi i shëndetit fizik, zhvillimi i njohurive shëndetësore, ndërgjegjësimi për shëndetin mendor, mjedisi mësimor i shëndetshëm, krijimi i vetëdijes shoqërore etj.

Me përmbushjen e këtyre masave synojmë të ndërtojmë një mjedis ku shërbimet shëndetësore janë lehtësisht të arritshme dhe cilësore në harmoni me nevojat e nënave dhe fëmijëve. Duke përmirësuar mbulueshmërinë dhe cilësinë e këtyre shërbimeve, ne veprojmë drejt qëllimit të garantimit të një jete të shëndetshme dhe të lumtur për të gjithë anëtarët e komunitetit tonë me theks të veçantë të fëmijëve.

4.2 Objektiva strategjike #2: Përmirësimi i mbrojtjes, sigurisë, ri-integrimit, risocializimit dhe mirëqenies sociale;

Qëllimi kryesor i këtij objekti është që të përmirësoj mirëqenien sociale të fëmijëve në mënyrë të qëndrueshme dhe të ndjeshme ndaj nevojave të tyre. Ky objektivi do të adresojë mundësitë dhe sfidat me të cilat përballen fëmijët në komunitetin tonë. Më tutje ky objektivi synon të ndërtojë një mjedis të përshtatshëm dhe të mbështetshëm për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Disa qëllime specifike të këtij objekti janë:

Objektiva specifike #2.1: *Zhvillimi dhe Fuqizimi i programit të strehimit familjar dhe farefisnor* - Familjet strehuese dhe farefisnore, kanë rezultuar të suksesshme si politikë dhe program për mbrojtjen e fëmijëve, andaj Komuna e Lipjanit do të zhvillojë politikë të përkujdesjes në komunitet përmes QPS-së, duke promovuar dhe mbështetur strehimin familjar përmes organizimit të fushatave vetëdijesuese, informuese në komunitet, për rolin dhe rëndësinë e familjes strehuese dhe farefisnore, duke bërë identifikimin, trajnimin dhe subvencionimin e tyre nga BK.

Objektiva specifike #2.2: *Ofrimi i shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë* – Ofrimi i shërbimeve për të gjithë fëmijët në nevojë është një synim kyç i planit të EDF që ka për qëllim të sigurojë që çdo fëmijë, pa dallim, të ketë mundësi për të përfituar nga shërbimet dhe ndihmat e nevojshme për zhvillimin, mirëqenien dhe përfshirjen e tyre në shoqëri. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për të gjithë fëmijët në nevojë ndikon në sigurimin e një shoqërie të drejtë duke kontribuar në zhvillimin e tyre të plotë dhe në ndërtimin e një të ardhme më të ndritshme. Kjo gjithashtu përkon me përpjekjet për të përmbushur qëllimet e trajtimit të drejtave të fëmijëve për të krijuar një shoqëri të mirëqenë për komunitetin fëmijë dhe gjithpërfshirëse në kuadër të drejtësisë sociale dhe të drejtave të fëmijëve si komunitet.

Kjo objektivi ka për qëllim të krijojë një ndryshim të qëndrueshëm në mirëqenien sociale të fëmijëve në komunën tonë. Përmes implementimit të hollësishëm të këtij objekti, ne synojmë

të krijojmë një mjedis ku fëmijët kanë mundësinë të rriten dhe zhvillohen në mënyrë të shëndetshme, të sigurt dhe të përkrahur.

4.3 Objektiva strategjike #3: Zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës; Në kuadër të Planit të EDF, një prej synimeve kryesore është zhvillimi i një sistemi arsimor

cilësor dhe gjithëpërfshirës. Ky synim ka për qëllim të sigurojë që të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh prejardhjen, gjininë, ose kushtet ekonomike, të kenë mundësinë për një arsimim dhe edukim cilësor duke ju ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie kualitative bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse. Për t'u realizuar qëllimi i këtij objektivi kemi paraparë disa objektiva specifike:

Objektiva specifike #3.1: *Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm*- këto masa synojnë përmirësimin e cilësisë së edukimit të hershëm dhe të rrisë nivelin e përfshirjes së fëmijëve në këtë proces të rëndësishëm. Përmirësimi i cilësisë së edukimit dhe rritja e përfshirjes së të gjithë fëmijëve ndikojnë në ndërtimin e një shoqërie më të informuar dhe të përparuar, ku secili fëmijë ka mundësi për të arritur potencialin e tij të plotë.

Objektiva specifike #3.2: *Përmirësimi i cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë*- synimi për përmirësimin e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në nivelet e ndryshme të arsimit është një përpjekje integrale që përket me zhvillimin e një sistemi arsimor efikas dhe të drejtë për të gjithë studentët. Ky synim thekson rëndësinë e një arsimit cilësor dhe të qasshëm për të gjithë, pavarësisht prej prejardhjes, statusit social ose aftësive individuale. Në kuadër të kësaj mase përcaktohen: trajnimi i punëtorëve të arsimit, përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, krijimi i programeve të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, zvogëlimi i numrit të nxënësve që braktisin shkollën, intervenimi i hershëm kundër dhunës, bullizmit dhe dukurive tjera negative, kujdesi për këshillimin dhe orientimin në karrierë.

Në kuadër të kësaj objektive janë përcaktuar disa veprime për ofrimin e sigurisë në shkolla dhe IP e të cilat janë: pajisja e të gjitha shkollave me kutitë e ndihmës së parë, mirëmbajtja e shenjave sinjalizuese të dukshme brenda në shkollë dhe para hyrjeve të shkollave për siguri më të lartë dhe pajisja me jelek sinjalizues për të gjithë nxënësit e klasave të para dhe të dyta.

4.4 Objektiva strategjike #4: Ofrimi i programeve të edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit;

Në kuadër të Planit të Veprimtë për të Drejtat e Fëmijëve, një qëllim i rëndësishëm është ofrimi i programeve të edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit për të përmirësuar zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve në komunitetin tonë. Pra, në këtë objektive janë përcaktuar katër objektiva specifike si më poshtë:

Objektiva specifike #4.1: *Ngritja e njohurive dhe shkathtësive të të rinjve përmes edukimit jo-formal* - në këtë plan janë përcaktuar aktivitete për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje të veçantë në zhvillimin e aftësive. Kjo përfshin zhvillim të aftësive të ndryshme, si artistike, kulturore, teknologjike, shkathtësive të buta dhe përkujdesja personale. Këto programe do të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë potencialin e tyre dhe t'i përgatitin për jetën në shoqëri dinamike dhe përparimtare.

Objektiva specifike #4.2: *Promovimi i praktikave të shëndetshme dhe rritja e mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve përmes aktiviteteve sportive dhe kulturore* - Në kuadër të Planit, aktivitetet për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore për fëmijët kanë një rëndësi të jashtëzakonshme. Kjo trashëgimi është e pasur dhe unike për secilën kulturë dhe komunitet, dhe është e rëndësishme që fëmijët të njohin, respektojnë dhe ndihmojnë në ruajtjen e identitetit kulturor dhe historisë së tyre. Me aktivitete e përcaktuara në këtë plan synohet zhvillimi i identitetit, ngritja e vetëdijes kulturore dhe forcimi i respektit dhe tolerancës. Pra, këto programe ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie të harmonizuar dhe të ndërgjegjshme për diversitetin.

Objektiva specifike #4.3: *Ngritja e vetëdijesimit dhe angazhimi aktiv i fëmijëve dhe të rinjve në mbrojtjen e mjedisit* - në këtë plan është përcaktuar organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative të ndryshme për fëmijët. Kjo përfshin gara sportive në kategori të ndryshme, dhe aktivitete të tjera që nxisin aktivitetin fizik dhe bashkëpunimin. Këto aktivitete do të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi fizike, emocionale dhe sociale, ndërsa gjithashtu promovojnë shëndetin dhe mirëqenien.

Këto masa synojnë të krijojnë një ambient ku fëmijët kanë mundësi të përmirësojnë aftësitë e tyre, të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të ndjehen të motivuar dhe të ndihmuar për të arritur sukses. Nëpërmjet angazhimit të tyre në programe të edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit, fëmijët do të ndihen të përkrahur për të ndjekur ëndrrat e tyre dhe të kontribuojnë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e komunitetit tonë.

4.5 Objektiva strategjike #5: Fuqizimi i mekanizmit komunal për të Drejtat e Fëmijëve; Në kuadër të Planit, objektiva e fuqizimit të mekanizmit komunal për të drejtat e fëmijëve ka për qëllim të ndërtojë një strukturë të fortë dhe të përshtatshme në nivel komunal për të siguruar respektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha fushat e jetës së tyre. Kjo objektive do të siguroj përfshirje aktive të komunitetit dhe angazhim të institucioneve për të siguruar një ndryshim pozitiv dhe të qëndrueshëm në trajtimin e fëmijëve në nivel lokal.

5.0 Zbatimi dhe monitorimi i planit të punës

Synimi kryesor i drejtorive të Komunës së Lipjanit, pa dyshim se është zbatimi në tërësi i dokumentit strategjikë, proces ky që do të përcaktohet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite.

Plani i Veprimit është tre vjeçar në të cilin janë përcaktuar objektivat specifike, aktivitetet

konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, treguesit SMART, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat duhet përllogaritur duke iu referuar buxhetit të paraparë në kornizën afatmesme Buxhetore (KAB) si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përllogaritjen e nevojave financiare duhet të merren në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Monitorimi do të jetë proces kyç për ofrimin e informatave të nevojshme për qëllime llogaridhënie, ai nuk do të jetë efektiv nëse nuk ndërmerren veprime ndaj asaj që është

vlerësuar dhe raportuar. Andaj, **çdo fund vit** Kryetari i Komunës dhe DSHPS në bashkëpunim me EDF, do të hartojë raportin vjetor i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve të realizuara, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike.

6.0 Ndikimi buxhetor për zbatimin e planit të punës për EDF

Plani i Veprimit për zbatimin e Planit të Punës për të EDF ka një kosto totale të zbatimit prej **2,293,080.00 Euro** për tri vite të zbatimit 2024-2026. Pjesa më e madhe e kostos (rreth 70% e buxhetit) do të përdoret për shpenzimet rrjedhës që lidhen me pagat, ngritjen e kapaciteteve, ngritjen e vetëdijesimit, rregullimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit që kanë të bëjë me të drejtat e fëmijëve.

Ligji për financimin e pushtetit lokal siguron një alokim të bazuar në formulë të transfereve qendrore, për të siguruar parashikimin e të ardhurave komunale, si dhe një masë barazimi mes komunave.

Ky ligj i ndan transferimet në komuna në tri grante kryesore:

- a. Granti i përgjithshëm;
- b. Granti specifik për Arsimin dhe
- c. Granti specifik për Shëndetësinë.

PLANI I PUNËS I EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE (2024-2026)

7.0 Plani i veprimit për EDF për vitin 2024-2026

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi i përkohshëm [2024]	Synimi i vitit të fundit [2025]	Rezultati
I. Objektivi strategjik: Përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë					
1	Treguesi: Numri i përgjithshëm i vizitave për fëmijët e posalindur dhe gratë shtatzëna	~110 vizita në shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal ~420 vizita në shtëpi nga ekipi profesional shëndetësor	208 800	100% e fëmijëve të posalindur! 100% mbulimi i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç dhe nënat	Të gjithë fëmijët dhe gratë shtatzëna marrin kujdesin e duhur nga shërbimet shëndetësore parësore në komunën e Lipjanit
2	Treguesi: % e shkallës së mbulueshmërisë së imunizimit të plotë në Komunën e Lipjanit	100% (komuniteti jo-shumicë) 85% (komuniteti shumicë)	100% (komuniteti joshumicë) 95% (komuniteti shumicë)	100% (komuniteti joshumicë) 100% (komuniteti shumicë)	Të gjithë fëmijët në komunën e Lipjanit jenë të vaksinuar dhe të imunizuar
3	Treguesi: Numri i fëmijëve të identifikuar me aftësi të kufizuara (të raportuara në bazë të institucioneve dhe moshës së fëmijëve) që pranojnë mbështetje materiale	121			Identifikimi i të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillimet e hershëm të tyre dhe përfshirja.
I.1 Objektivi specifik: Zbatimi i Programi të Vizitave në Shtëpi					
2	Treguesi: Numri i fëmijëve të identifikuar me aftësi të kufizuara përmes vizitave në shtëpi	5			Identifikim të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në moshën e hershme përmes vizitave në shtëpi.
3	Treguesi: Numri i punonjësve shëndetësor të trajnuar për fuqizim të ekipit të vizitave në shtëpi	25	30	35	Të gjithë punonjësit shëndetësor për programin vizita në shtëpi kanë ndjekur trajnimet sipas nevojës.
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti		Produkti (Output)
			2024	2025	2026
					Burimi i financimit
					Institucioni udhëheqës

									dhe mbështetës	Nr. i aktiviteteve të realizuara (numri i sesioneve për ushqyeshmërinë e drejtë me nëna me fokus nënat në vendet rurale)
I.1.1	Aktivitate për ngritjen e vetëdijes së prindërve për rëndësinë e ushqyeshmërisë së drejtë	2024-2026	400.00	400.00	400.00	Komuna Donatorët	400.00	QKMF DSHPS	Nr. i aktiviteteve të realizuara (numri i sesioneve për ushqyeshmërinë e drejtë me nëna me fokus nënat në vendet rurale)	
I.1.2	Ristrukturimi dhe sigurimi i burimeve njerëzore në vazhdimësi për realizimin e qëndrueshmërisë së programit të vizitave në shtëpi.	2024	3,000.00	3,000.00	3,000.00	Komuna MSH	3,000.00	QKMF DSHPS MSH	Nr. i stafit të ristrukturuar dhe nr. i stafit të angazhuar.	
I.1.3	Trajnimi i punëtorëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijëve, për këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme në kuadër të vizitave në shtëpi	2024-2026	2,000.00	2,000.00	2,000.00	Komuna Donatorët	2,000.00	QKMF DSHPS MSH UNICEF	Nr. i stafit të trajnuar lidhur me kujdesin shëndetësor ndaj nënave dhe ushqyeshmërisë	
I.1.4	Shpërndarja e pakove për nëna dhe të posalindur në kuadër të vizitave shtëpiake	2024-2026	80,000.00	80,000.00	80,000.00	Komuna Donatorët	80,000.00	QKMF DSh	Nr. fëmijëve që kanë përfutur me pako higjienike dhe pelena. (~2000 lindje në vit: a) Lista e produkteve për fëmijën x 25 €	

PLANI I PUNËS I EKPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE (2024-2026)

I.1.5	Pajisja e ekipit me pompa për gji dhënie, peshore dhe materiale tjera të nevojshme	2024-2026	20,000 €	1,000 €	1,000 €	Komuna	DSHPS QKMF	b)Lista e produkteve për nënën x 25 € Lista e pajisjeve të blera
I.1.6	Organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, që do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ dhe psiko-social	2024-2026	7,000.00	7,000.00	7,000.00	Komuna	QKMF DSh MSH	Nr. i vizitave të organizuar në bashkëpunim me psikologun/en. Duke angazhuar staf të ri me profesionin e psikologut/es.
